

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK godet sërish grupin e
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/spak-operacion-lwshohen-disa-urdhwr-arreste?r=kh0
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:35:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:30:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7be0bb38aafe679f7d8c4771c8d8ab7e2497757b9235b0be583ba9a1caf2501a
TEKSTI	582462ec11620217e5d56ef675b07008d689c7244d7b7d2d72b04fd92d25816f
PAMJA	c159432e139dfba7bed8ceb7ac7a13a9dd4ccd8bc8e276934d788742d955b7a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac3e1042e0b73939f1ffac64dc0ca9504d6954d5d33b4be038bd5b1b8a50ad44
E MËPARSHMJA	eeef1a59b3dc832ec147781eb12e1ee754295a38e6a6250615c98793967b2b2b5
RRËNJA MERKLE	2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac3e1042e0b73939f1ffac64dc0ca9504d6954d5d33b4be038bd5b1b8a50ad44>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Flash

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Seanca konstituive në Kosovë, deputetët e Vetëvendosjes mbërrijnë në Kuvend



Kronikë

SPAK godet sërish grupin e 'Rrajave', shpall në kërkim Indrit Doklen, në pranga një tjetër! Akuzohen për trafik droge! VIDEO e operacionit

SPAK zbarchi 3 episode të reja të trafikut të drogës pas zbërthimit të komunikimeve në "SkyECC". Hetimi është fraksion i dosjes që goditi më herët anëtarë të grupit "Rraja".

■ Në kërkim nga SPAK, kush është ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar

■ U arrestua me urdhër të SPAK, kush është Bledar Cafi, i dënuar në Itali për trafik droge



Keti Banushi

26 Shtator, 10:25 | Përditësimi: 26 Shtator, 12:14


f Share Tweet



TIRANË- Indrit Dokle, një emër i shumëpërfolur i botës së krimit dhe ish-anëtar i bandës së Durrësit, është shpallur sërish në kërkim me urdhër të SPAK i akuzuar për trafik droge si pjesë e grupit të 'Rrajave'. Masa e sigurisë "arrest me burg" ndaj Dokles u caktua një ditë më parë me vendim të GJKKO-së.

Në orët e para të mëngjesit, Policia e Shtetit dhe BKH ushtruan kontrolle në disa vende në pronësi të Dokles, por pa rezultat. Operacioni i SPAK u shtri si në Tiranë, edhe në Shkodër ku u kap një tjetër person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, Bledar Cafi, i dënuar edhe nga Italia për trafik droge. Forcat RENEa zbarkuan në banesë e tij, e rrethuar me mure të larta, dhe e prangosën për llogari të SPAK.

Tre episode të reja të trafikut të drogës u zbardhën nga SPAK pas zbërthimit të bisedave në aplikacionin "SkyECC". Si Dokle edhe Cafi janë hetuar si fraksion i një dosje po për trafik droge, nga e cila në dhjetor 2025 u lëshuan 15 masa sigurie, mes tyre edhe për anëtarë të grupit Rraja.



LEXO EDHE:
Në kërkim nga SPAK, kush është ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar

Kjo është masa e dytë e sigurisë që lëshohet për Doklen, i cili është dërguar për gjykim në GJKKO i akuzuar se siguroi kushtet për të vrarë Arben Ndokën.

Njoftim i policisë së shtetit

Finalizohet operacioni policor i koduar "Muri i Lartë".

Operacioni nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me BKH-në, nën drejtimin e SPAK.

Kapet dhe vihet në pranga një shtetas me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Vijon puna për kapjen e një shtetasi tjetër, i cili gjatë operacionit nuk u gjet në banesë.

Strukturat operacionale dhe hetimore të Policisë së Shtetit, konkretisht Forcat Speciale Renea, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve, DVP Shkodër dhe BKH, nën drejtimin e SPAK, në zbatim të urdhrit të Prokurorisë së Posaçme SPAK dhe të vendimit të Gjykatës, kanë zhvilluar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Muri i Lartë", me qëllim ekzekutimin e masës së sigurimit personal ndaj një shtetasi, si dhe kryerjen e kontrolleve për lokalizimin dhe kapjen e një shtetasi tjetër, i shpallur në kërkim.

Në kuadër të operacionit në Shkodër u bë e mundur kapja dhe arrestimi i shtetaseit R. C. 50 vjeç, lindur

me rreze të operimit, në shtet dhe në bashkëpunim me grupin e shpallur në kërkim, si dhe banues në Shkodër, person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Kapja dhe arrestimi i tij u bë në orët e para të mëngjesit të sotëm, në banesën e tij në Shkodër. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 25.09.2026, ka caktuar për këtë shtetas masën e sigurimit personal "Arrest me burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Po në zbatim të vendimit të GJKKO-së, u ushtrua kontroll në vendet që i përkasin shtetasit në kërkim E. D., alias I. D., 43 vjeç, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, person në kërkim që prej vitit 2024, për të cilin GJKKO ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formë të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Gjatë kontrolleve, ky shtetas nuk u gjet dhe vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Lajmi në përditësim....

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 11:35

U arrestua me urdhër të SPAK, kush është Bledar Cafë, i dënuar në Itali për trafik droge



Bledar Cafë, 50 vjeç, i konsideruar nga autoritetet si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, u arrestua me urdhër të SPAK, pasi akuzohet si pjesë e një grupi kriminal të trafikut të drogës. Cafë rezultoi person me precedentë të mëparshëm kriminalë dhe është dënuar më herët në Itali për trafik narkotikësh.


Më 4 qershor 2020, Gjykata e Triestes e dënoi Cafin me 4 vite e 2 muaj burg për trafik droge në sasi të mëdha dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal. Ai u shpall në kërkim ndërkombëtar dhe më 25 janar 2021 në Shkodër nga policia shqiptare me qëllim ekstradimin drejt Italisë për të vijuar vuajtjen e dënimit.


SI.E/Shqiptarja.com

[f Share](#)

Ora 11:25

Në kërkim nga SPAK, kush është ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar





SPAK lëshon urdhër-arrest për ish-anëtarin e Bandës së Durrësit, Indrit Dokle, i akuzuar si pjesë e një grupi kriminal të trafikut të drogës. Me urdhër të SPAK u ushtruan kontrolle në disa ambiente në pronësi të Dokles, por ai nuk është gjetur.

Kjo është masa e dytë e sigurisë që lëshohet për Doklen, i cili është dërguar për gjykim në GJKKO i akuzuar se siguroi kushtet për të vranë Arben Ndokën.

Emri i Dokles është shfaqur në disa dosje të SPAK kryesisht si objektivi i planeve për eliminimin e tij. Në dosjen "Plumbi i Artë", i penduari i drejtësisë Nuredin Dumani ka dëshmuar se Ervis Martinaj, i zhdukur prej gushtit 2022, **i kishte ofruar 500 mijë euro për vrasjen e Dokles**, nga të cilat pretendonte se kishte marrë 100 mijë euro parapagim.

Pas zhdukjes së Ervis Martinajt në gusht të vitit 2022, Dokle u mor në pyetje nga hetuesit. Familjarët e Martinajt kishin kërkuar të hetohej edhe pista e një hakmarrjeje të mundshme nga Dokle, nisur nga pretendimi i Dumani se Martinaj kishte porositur vrasjen e tij.

Emri i Dokles doli edhe në një tjetër procedim të SPAK. Më 2 qershor 2026, **GJKKO dënoi** Elvin Merlikën dhe Alket Xhixhën për sigurimin e kushteve për vrasjen e tij, në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal.

Indrit Dokle ishte dënuar me burgim të përjetshëm për krimet e kryera kur ishte pjesë e Bandës së Durrësit, por në janar 2020 fitoi lirinë me vendim të gjyqtarës së Krujës, Enkelejda Hoxha. Ajo i shujti dënimin e përjetshëm duke e konvertuar në 25 vite burg dhe më pas e liroi me kusht, duke i kaluar 5 vitet e mbetura në shërbim prove. Dokle kishte qëndruar në qeli që prej vitit 2005. Prokuroria e Krujës e ankmoi vendimin, duke argumentuar se Dokle është një përsëritës krimesh dhe nuk plotësonte kushtet ligjore për lirimin me kusht, por kërkesa është ende në Apel dhe nuk është caktuar ende data për shqyrtimin e saj.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: trafik droge Tirane indrit dokle spak Shkoder Bledar Cafi

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera



Në kërkim për trafik droge, ukrainasi arrestohet sapo zbret në Rinas! U kap pas informacioneve nga Ambasada e SHBA-së (EMRI)

26 Shtator, 09:42



Sot ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, policia plan masash! Nga ora 17:00 bllokohen rrugët rreth stadiumit 'Air Albania'

26 Shtator, 09:06



Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të saj



Lorenc Vangjeli

25 Shtator, 21:48



Pjesë e grupit që 'mbyti' Europën me kokainë, Eldi Dizdari do të ekstradohet nga Dubai në Belgjikë, do të vuajë dënimin me 10 vite burg

25 Shtator, 21:30

Biznesi në vështirësi nga rënia e euros dhe rritja e kostove, prodhuesit në Shkodër: Na krijoni lehtësira që të ekzistojmë



Ergys Kavaja

25 Shtator, 17:31

Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, taksia përplasat me furgonin me mësues! 3 të plagosur

25 Shtator, 15:06



Shqiptari nga Kosova plagoset me armë zjarri pranë Zogut të Zi në Tiranë, të paqarta rrethanat! Arratiset autori (EMRI)

25 Shtator, 14:54



Mediat: SPAK do marrë në pyetje dhe kreun e sapo komanduar të SHISH dhe drejtorin e operacioneve! 'U kapën duke fshirë serverët e SHISH?!'

25 Shtator, 13:43



Territorialja, Këshilli i Tiranës kërkon Veliajn në mbledhjen e 29 shtatorit! Shkresë SPAK dhe Burgjeve: Lejojeni fizikisht ose me videokonferencë

25 Shtator, 13:34



Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Shkodrës jep pëlqimin! PD voton kundër, debate edhe për statusin e Dukagjinit dhe Velipojës (VIDEO)



Ergys Kavaja

25 Shtator, 13:04



Hemodializa sërish privatit, anulohet tenderi 50 milionë euro! Agjencia e Prokurimit Publik: Gabime dhe mangësi në dokumente

25 Shtator, 12:54



U ekstradua nga Italia dy ditë më parë, GJKKO lë në burg anëtarin e 'Visit të Pojës'



Keti Banushi

25 Shtator, 11:05

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.